

# Statistikat afatshkurtra


## Prodhuesit e të mirave - Tremujori IV 2017

**Tiranë, më 16 Mars 2018:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, të cilat përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

### Industri:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 1,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 5,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




### Energji elektrike, Gaz, Avull

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 21,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rënie 11,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 18,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)




### Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 8,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 6,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 8,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (%)**




**Ndërtim**

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e katërt 2017, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 7,5 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2016;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 7,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 1,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 13,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)**



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / III.17 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	115,1	1,5	109,9	2,3
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	130,0	-7,7	123,0	3,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	121,8	5,2	116,7	2,1
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	171,0	21,3	171,3	-1,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	154,2	8,6	154,1	-3,0
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	137,6	7,5	116,7	-3,5
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	135,9	7,0	127,8	2,1
		Energji	118,9	13,7	118,7	0,8
		Mallra kapitale	178,2	7,1	157,8	0,4
		Mallra të qëndrueshme konsumi	153,3	-17,4	123,4	-0,8
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	126,2	-3,2	124,1	0,0

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / III.17 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	144,0	3,0	139,8	3,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	147,9	0,7	148,2	7,5
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	132,2	4,5	126,7	1,8
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	109,4	-11,2	129,0	18,7
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	103,7	6,1	104,1	-2,6
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	138,7	7,5	110,6	-7,0
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	198,3	11,6	186,4	2,7
		Energji	119,8	-8,1	121,4	9,5
		Mallra kapitale	491,8	24,0	448,0	15,4
		Mallra të qëndrueshme konsumi	97,6	-27,7	81,4	-6,0
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	121,9	-5,9	122,2	-2,3

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Numri i të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)	Tr.IV 2017 (2010=100)	IV.17 / IV.16 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	142,1	1,0	183,6	5,7
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	100,4	0,5	190,1	1,7
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	149,6	1,0	178,8	8,3
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	116,2	2,4	191,2	18,9
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	153,4	8,4	172,1	3,6
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	127,6	1,4	161,9	13,7

# Shënime metodologjike

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

*Ndryshimi tremujor në përqindje* - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtë vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

**Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumën e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përjashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfeksionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

**Përshtatja sezonale**

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori IV 2017. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.